



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E ARTEVE
REKTORATI

Bul: Dëshmorët e Kombi, Sheshi Nënë Tereza, Tiranë www.artacademy.al Tel /Fax: +335 42 225488

Nr. 613 Prot.

Tiranë, më 08. 07. 2011

N J O F T I M

Në Akademinë e Arteve regjistrimet për konkursin e pranimit fillojnë nga data **16 Gusht 2011 deri në orën 12.00 të datës 27 Gusht 2011**. Orari për regjistrim do të jetë 08.00-16.00, pranë Sekretarive të Fakultetit.

Konkurenti në momentin e regjistrimit duhet të paraqesi këto dokumenta:

1. Dokument identifikimi (fotokopje ID, pasaportë)
2. Kërkesë personale e kandidatit.
3. Dokument që vërteton pagesën e tarifës së regjistrimit prej 5000 (pesëmijë) lekë.
3.1 Pagesa për regjistrim do të kryhet pranë Bankave të nivelit të dytë ose zyra të Postës Shqiptare. Kandidati duhet të paraqitet në Drejtorinë Ekonomike të Akademisë së Arteve dhe të tërheqë formularin përkatës me të cilin paraqitet pranë Bankës ose Postës Shqiptare për të kryer pagesën prej 5000 (pesëmijë) lekë, për llogari të Akademisë së Arteve.
4. Periudha e regjistrimit për kandidatët do të jetë në datat 16 – 27 Gusht nga ora 08.00-16.00. Në datën 27 Gusht regjistrimi do të jetë deri në orën 12.00. Në të njëjtin afat regjistrohen edhe kandidatët nga Trojet.
5. Studentët që vijojnë një program të dytë studimi do t'i nënshtrohen konkursit të pranimit.
6. Për të gjitha programet e studimit në Akademinë e Arteve datat e konkursit të pranimit do të jenë : 29 Gusht – 2 Shtator 2011.
7. Paraqitja e konkurentëve për zhvillimin e konkursit do të jetë në orën **8.00 të datës 29 Gusht**. Ata duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit (ID ose pasaportë). Mungesa e dokumentit të identifikimit, shkakton mos lejimin e kandidatit për të hyrë në konkurs.
8. Për sqarime të mëtejshme ju lutemi të paraqiteni pranë Sekretarive të Fakulteteve në Akademinë e Arteve.

